



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /
GOVERNMENT OF KOSOVA



Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo unutrašnjih poslova
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

Raport përfundimtar Nr. 5/2013

DHOMAT E DËSHMIVE NË POLICINË E KOSOVËS



Nëntor 2013

SHKURTESAT

IPK.....Inspektorati Policor i Kosovës

PK.....Policia e Kosovës

KPPK.....Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

PSO.....Procedurë Standarde e Operimit

DI.....Departamenti i Inspektimeve

DRP.....Drejtorit Rajonale të Policisë

**ICITAP.....Internacional Criminal Investigative Training Assistance
Program**

PËRMBAJTJA

1.PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

2.PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM PËR HAPAT E NDËRMARRA GJATË INSPEKTIMIT

3. HYRJE

4. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE NË PËRGJITHËSI

4.1 Zbatimi i procedurave dhe rregullave mbi vendosjen (Pajisjet - Inventarin në dhomën e dëshmime).

4.2 Zbatimi i procedurave dhe rregullave mbi ruajtjen dhe trajtimin e sendeve.

4.3 Zbatimi i procedurave lidhur me Sigurinë.

4.4 Zbatimi i procedurave sa i përket paketimit -shënimeve të dëshmimeve të konfiskuara

4.5 Zbatimi i procedurave lidhur me evidentimin e dëshmimeve të konfiskuara.

4.6 Gjithë-përfshirja

5. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

5.1 Përfundimi

5.2 Rekomandim

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Bazuar në Programin e Punës Inspektuese, Departamenti i Inspektimeve të IPK-së ka kryer një inspektim të rregullt në Dhomën Qendrore të dëshmimeve në kuadër të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse të Policisë së Kosovës, si dhe në gjashtë dhomat e dëshmimeve që gjenden në kuadër Drejtorive Rajonale Policore DRP-Prishtinë, DRP- Prizren, DRP-Pejë, DRP- Mitrovicë, DRP-Gjilan dhe DRP- Ferizaj.

1.2 Në përgjithësi në dhomat e dëshmimeve janë të vendosura inventar (pajisje) që shërbejnë për mbarëvajtjen e punës. Ajo që e ka përcjell nivelin jo të kënaqshëm të saktësisë në këtë objektiv janë mungesa e disa pajisjeve siç janë kontinierët e posaçëm për vendosjen e sendeve/dëshmimeve të specifikuara, rafteve lëvizëse të cilat do të mundësonin arritjen e një hapësire deponuese më të madhe, si dhe mungesa e dhomave ndarëse apo kupolave të veçanta brenda zonës deponuese për të vendosur armët e zjarrit.

1.3 Ruajtjes dhe Trajtimit të sendeve/dëshmimeve ju është kushtuar kujdes nga zyrtarët policor që janë përgjegjës për dhomat e dëshmimeve. Problemet kryesore në këtë objektiv ishin ato me lagështinë në dy dhoma të dëshmimeve, në disa raste mbajtja e sendeve/dëshmimeve në frigorifer tek laboratorët e forenzikës dhe paketimi i dëshmimeve në kuti jo standarde mund të vë në pyetje ruajtjen dhe trajtimin e duhur për sendet/dëshmitë.

1.4 Objektivin e sigurisë e ka përcjell standardi i lartë ku në të është përfshirë edhe elementi më i vogël si kërkesë për të përmbushur sigurinë. Dhomat e dëshmimeve në veçanti dhoma qendrore e dëshmimeve edhe pse me një avancim të lartë në kushtet e sigurisë me donacionet nga ICITAP ende kërkon angazhim për të arritur në nivelin e kënaqshëm. Shumicës së dhomave të dëshmimeve ju ka munguar shuarësi i zjarrit, si dhe dy nga dhomat e dëshmimeve nuk kanë qenë të siguruara ku kapëset e derës kanë qenë të montuara nga jashtë.

1.5 Sa i përket paketimit - shënimeve të sendeve/dëshmimeve të konfiskuara nga 91 raste të kontrolluara 68 prej tyre kanë përmbushur standardin për objektivin e caktuar. Në disa raste dëshmitë nuk janë paketuar të veçuara nga njëra tjetra ose ka pasur raste ku edhe përkundër rregullave ato nuk janë paketuar në qese letre, si dhe ka pasur mos njohuri rreth fazës se kur fillon plotësimi i zinxhirit të ruajtjes.

1.6 Evidentimi si objektiv nga 91 raste të kontrolluara prej tyre 66 kanë përmbushur standardin nga objektivi i caktuar. Gjersa ka pasur raste kur evidentimi i sendeve/dëshmimeve, edhe pse nuk ka munguar asgjë, nuk është bërë në mënyrë ekuivalente si në libër regjistrim (fletore) ashtu dhe në data bazën elektronike.

1.7 Ndërsa sa i përket gjithë përfshirjes janë prezantuar çështje që nuk kanë qenë të përfshira në ndonjërin objektiv por që gjatë punës kanë dalë si të rëndësishme për tu trajtuar. Andaj, dokumentet PSO që rregullon dhomat e dëshmive kërkojnë një ndryshim thelbësor si shkak i centralizimit të dhomës qendrore të dëshmive. Po ashtu si çështje tjetër e identifikuar ka qenë dhe raportimi për kryerjen e revizionimeve/ inventarizimeve dhe inspektimeve në dhomën e dëshmive si një nga pikat e dobëta të shumë drejtorive që kanë ngecur në ushtrimin e një kontrolli më të rreptë mbi dëshmitë dhe evidencat.

1.8 Duhet theksuar që gjatë leximit të raportit mund të vërehet se disa faza të sendeve/dëshmive të konfiskura i takojnë drejtpërdrejt njësiteve të forenzikës por, që në periodhat pasuese disa nga detyrat dhe përgjegjësit e zyrtarit të dhomës së dëshmive kanë të bëjë me pranimin, regjistrimin - ruajtjen e sendeve/dëshmive, të sigurohet për mënyrën e drejtë të paketimit dhe ruajtjes së sendeve dhe dëshmive të ndryshme, si dhe të drejtën e zyrtarit policor për mospranimin e sendeve/dëshmive kur ato paraqiten në mënyrë jo të sigurt , jo complete apo që bie ndesh me përcaktimet e definuara në PSO-it.

1.9 Inspektorati Policor i Kosovës pasi ka zhvilluar Inspektim te Rregullt të Dhomave të Dëshmive në Policinë e Kosovës dhe ka nxjerr raportin e saj i cili paraprakisht është diskutuar me zyrtaret e larte të PK-së si Udhëheqësit e Departamenteve te Hetimeve, Operatives dhe Shërbimeve Mbështetëse në PK, Drejtoret Rajonal dhe pas marrjes së komenteve të tyre lidhur me te gjeturat e këtij raporti, ky raport ka marr formën përfundimtare.

2. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM PËR HAPAT E NDËRMARRA GJATË INSPEKTIMIT

2.1 Ky inspektim është inspektim i përputhshmërisë nga i cili është kërkuar një përputhshmëri në mes bazës ligjore dhe ekzekutimit të punës në terren.

2.2 Gjatë rrjedhës së inspektimit, IPK fillimisht ka bërë analizimin e neneve të Kodit Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) me të cilët rregullohet fusha e konfiskimit të sendeve të cilat mund të jenë prova gjatë një procedure penale ose që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale dhe për të cilat ligji parasheh konfiskim apo sekuestrim. Po ashtu është bërë analizimi i Procedurës Standarde të Operimit të PK-së që rregullojnë Dhomat e Dëshmimeve sa i përket vendosjes, trajtimit, ruajtjes, sigurisë, paketimit-shënimeve si dhe evidentimit të sendeve dhe dëshmimeve të konfiskuara.

2.3 Në bazë të programit inspektues, inspektorët kanë përpiluar dy pyetësor të cilët së bashku kanë përfshirë pesë (5) objektiva e që kanë pasur të bëjnë me Vendosjen (Pajisjet – Inventarët në dhomën e dëshmimeve), Trajtimin dhe Ruajtjen, Sigurinë, Paketimin- Shënimet si dhe Evidentimin e sendeve dhe dëshmimeve të konfiskuar apo sekuestruara. Këta dy pyetësor në vete kanë paraparë gjithsej tridhjetë pyetje të cilat kanë qenë të shpërndara në objektivat e cekura më lartë dhe për të cilat është dashur të merren përgjigje konkrete në secilën dhomë të dëshmimeve e cila ka qenë pjesë e inspektimit.

2.4 Për më tutje objektivat e përcaktuar janë ndarë në dy pjesë ku pjesa e parë ka pasur të bëjë me një inspektim të përgjithshëm në dhomat e dëshmimeve dhe ka përfshi objektivat lidhur me Vendosjen (Pajisjet –Inventarët në dhomën e dëshmimeve), Trajtimin-Ruajtjen, dhe Sigurinë ku si rrjedhojë është bërë adoptimi i metodologjisë dhe kanë hy në proces të mostrës Dhoma qendrore e dëshmimeve, DRP-Prishtinë, DRP-Prizren, DRP-Pejë, DRP-Mitrovicë, DRP-Gjilan dhe DRP-Ferizaj. Nga kjo rrjedhojë del se kemi mostruar shtatë (7) dhoma të dëshmimeve.

2.5 Ndërsa sa i përket objektivave që kanë përfshi Paketimin- Shënimet si dhe Evidentimin metodologjia Randomizer nga totali prej 921 rasteve të regjistruara në librat e evidencave të Policisë së Kosovës për vitin 2012 (Dhomën Qendrore të Dëshmimeve, Drejtorinë Rajonale Prishtinë, Drejtorinë Rajonale Prizren, Drejtorinë Rajonale Pejë, Drejtorinë Rajonale Mitrovicë, Drejtorinë Rajonale Gjilan dhe Drejtorinë Rajonale Ferizaj) ka përzgjedhur kontrollimin e 91 rasteve.

2.6 Metodologjia e përdorur e punës ka ngërthyer në vete një proces i cili kërkon që çdo pyetje e secilit objektiv të jep përgjigje pozitive që të konsiderohet se standardi është përmbushur për objektivin e përcaktuar. Varësisht nga rezultati i këtij numërimi janë paraqitur dhe të gjeturat në raport.

3. HYRJE

3.1 Operacionet policore shpesh përcillen me gjetjen dhe konfiskimin e sendeve në vend ngjarje. Andaj një nga detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të policisë është gjetja dhe ruajtja e provave të veprave penale që mund të përdoren në procedurë penale. Ashtu siç vihet në vështirësi policia për të bërë gjetjen e provave, nëpër të njëjtat vështirësi kalon dhe për të bërë ruajtjen e këtyre provave të cilat në rast të ndonjë humbje të saj do të rrezikohet reputacioni i policisë i cili është i thirrur për zbatim të ligjit. Pra para policisë vihet një sfidë në trajtimin dhe ruajtjen e dëshmive të cilat në procedurë penale konsiderohen si hallka kryesore që lidh të dyshuarin me krimin. Për dhënien e një opinioni të paanshëm dhe të drejtë mbi të menaxhuarit e këtyre dëshmive nga përgjegjësit e dhomave të dëshmive, bazuar në Planin e Inspektimit për vitin 2013, është ndër e nevojshme kyçja e IPK-së në funksionalizimin e një inspektimi të rregullt.

3.2 Inspektorati Policor i Kosovës ka autorizuar inspektimin për të vlerësuar kryerjen e detyrave nga përgjegjësit e dhomave të dëshmive. Inspektimi është ndërmarrë pasi menaxhmenti i IPK-së është siguruar se ka në dispozicion burime njerëzore të mjaftueshme që në mënyrë të suksesshme të kryejë vlerësimin e kryerjes së detyrave nga punonjësit brenda dhomave të dëshmive. Kjo fushë e menaxhimit nuk inspektohet për herë të parë dhe vlerësohet se në të ardhmen duhet të vazhdohet me iniciativat e tilla inspektuese.

3.3 Qëllimi i organizimit dhe funksionalizimit të këtij inspektimi ka qenë që të vlerësohet kryerja e detyrave në përputhje me legjislacionin, të vlerësohet niveli i sigurisë së dhomave të dëshmive, të jepet një mendim objektiv mbi respektimin e dispozitave ligjore, procedurave dhe rregullave në fuqi, si dhe të jepen rekomandime për përmirësimin e performancës policore në këtë fushë menaxheriale.

3.4 Objekt i këtij inspektimi të rregullt ishte vlerësimi i nivelit të sigurisë në dhomat e dëshmive, respektimi i procedurave/rregullave në trajtimin dhe ruajtjen e dëshmive dhe vlerësimi i performancës së përgjegjësve policorë të dhomës në kryerjen e detyrave në këtë fushë të menaxhimit, kurse subjekt i inspektimit ishte;

- Dhoma Qendrore e Dëshmive në kuadër të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse të PK.
- Dhoma e Dëshmive në Drejtorinë Rajonale Prishtinë
- Dhoma e Dëshmive në Drejtorinë Rajonale Prizren
- Dhoma e Dëshmive në Drejtorinë Rajonale Pejë
- Dhoma e Dëshmive në Drejtorinë Rajonale Mitrovicë
- Dhoma e Dëshmive në Drejtorinë Rajonale Gjilan
- Dhoma e Dëshmive në Drejtorinë Rajonale Ferizaj.

3.5 Me rastin e planifikimit të aktiviteteve në funksionalizimin e inspektimit të paralajmëruar, DI-ja ka vënë para vetes këto objektiva të inspektimit:

- Vlerësimin e mënyrës së të udhëhequrit dhe të funksionarit të Dhomës Qendrore të Dëshmive, si dhe dhomave të dëshmive të vendosura pranë gjashtë drejtorive rajonale.
- Vlerësimin e nivelit të sigurisë dhe kushteve të punës brenda Dhomës Qendrore të Dëshmive, si dhe dhomave të dëshmive të vendosura pranë gjashtë drejtorive rajonale.
- Vlerësimin mbi respektimin e procedurave dhe rregullave në pranimin, vendosjen, trajtimin, ruajtjen, paketimin-shënimet, evidentimin dhe daljet e autorizuara të sendeve dhe dëshmive të konfiskuara.
- Evidentimin e mangësive dhe shkeljeve evidente lidhur me aktivitetet e udhëhequra nga përgjegjësit e Dhomës Qendrore të Dëshmive, si dhe dhomave të dëshmive të vendosura pranë gjashtë drejtorive rajonale.

3.6 Si metodologji pune është marrë për bazë periudha kohore dhe popullacioni (Numri i dhomave të dëshmive dhe numri i rasteve).

3.7 Departamenti i Inspektimeve me anë të metodës randomizer¹ në proces statistikor ka selektuar nga totali prej 921 rasteve të regjistruara në librat e evidencave të Policisë së Kosovës për vitin 2012 (Dhomën Qendrore të Dëshmive, Drejtorinë Rajonale Prishtinë, Drejtorinë Rajonale Prizren, Drejtorinë Rajonale Pejë, Drejtorinë Rajonale Mitrovicë, Drejtorinë Rajonale Gjilan dhe Drejtorinë Rajonale Ferizaj) ka përzgjedhur kontrollimin e 91 rasteve. Mostra² është përzgjedhur për periudhën kohore 01 janar 2012 deri me 31 dhjetor 2012 nga e cila është përcaktuar se dosjet e rasteve, a janë në përputhshmëri të plotë me standardet e përcaktuara nga objektivi i inspektuar.

3.8 Ndërsa në rastet ku janë trajtuar objektivat lidhur me vendosjen, (pajisjet-inventarin e sendeve/dëshmive të konfiskuara) ruajtjen dhe trajtimin, si dhe sigurinë DI-ve, në mënyrë analoge ka bërë modifikimin e metodologjisë. Kështu që sa i përket tri objektivave të cekura më lartë kemi mostrën prej shtatë (7) dhomave të dëshmive të cilat kanë qenë pjesë e inspektimit dhe nga ku është përcaktuar përputhshmëria e plotë e standardeve me objektivat e inspektuara.

3.9 Duke pasur parasysh faktin se IPK-ja është agjenci ekzekutive në kuadër të MPB-së që zhvillon në mënyrë të pavarur funksionet e saj të bazuara në Ligjin nr. 03/L-231 për IPK-në,

¹ Randomizer është një algoritëm (metodë-rasti) e cila përzgjedh numrat në mënyrë të paparashikueshme të paanshme dhe të pavarur.

² Madhësia e mostrës është arritur me saktësinë dhe besueshmërinë në lartësi prej 95%, ndërsa besueshmëria për gabim arrin lartësinë në 5%.

nga organizata pritet të dal me një vlerësim real mbi përputhshmërinë e punës policore kundrejt bazës ligjore. E autorizuar të kryejë këtë inspektim, IPK-ja ka angazhuar inspektorët, të cilët në vazhden e nxjerrjes së informacionit të duhur, gjatë procesit inspektues kanë siguruar:

- kopje të raporteve të punës, kopje të dosjeve hetimore, kopje të raporteve të inspektimit, kopje të raporteve të inventarizimit, kopje të zinxhirëve të ruajtjes, etj.
- informata nga pyetësorët e përpiluar nga DI-ja, me të cilët janë verifikuar kushtet e sigurisë dhe te punës dhe zbatimi i rregullave nga personeli i dhomës.
- pamje vizuale të konkretizuara me fotografi nga dhoma e dëshmime, zinxhirët e ruajtjes së dëshmime³ dhe regjistrat e dëshmime⁴.
- intervista nga punonjës policorë të nivelit të lartë drejtues dhe zbatues, si në vijim:
 - Ndihmësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë për Shërbime Mbështetëse,
 - Ndihmësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë për Hetime,
 - Drejtorët e gjashtë Drejtorive Rajonale Policore,
 - Shefat e Hetimeve në Drejtoritë Rajonale Policore,
 - Përgjegjësit e Dhomës Qendrore të Dëshmime,
 - Përgjegjësit e Dhomave të Dëshmime në Drejtoritë Rajonale.

3.10 Inspektimi i zhvilluar është përqendruar në këto drejtime apo fusha kryesore:

- Organizimi, udhëheqja dhe menaxhimi i burimeve njerëzore.
- Kushtet e sigurisë dhe të punës në Dhomat e Dëshmime.
- Zbatimi i procedurave dhe rregullave në pranimin, vendosjen, trajtimin-ruajtjen, paketimin-shënimet, evidentimin e sendeve dhe dëshmime të konfiskuara.

3.11 Inspektimi i autorizuar është bazuar në këtë kuadër ligjor:

- Ligjin nr. 03/L-231 për IPK-në,
- Udhëzimin Administrativ nr. 11/2011-MPB për Inspektime në PK,
- Autorizimin zyrtar të lëshuar më 7 tetor të këtij viti për kryerjen e inspektimit.

3.12 Gjatë inspektimit të kësaj fushe të menaxhimit policor, inspektorët e DI-së kanë konsideruar se dokumentet në vijim do të jenë baza e duhur, në të cilën duhet mbështetur puna e tyre:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës.
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës.
- Ligji nr. 03/L-035 për Policinë e Kosovës.
- Procedurat Standarde të Operimit “Vendosja, trajtimi, ruajtja e sendeve dhe dëshmime të konfiskuara” (nr. PK/Sh-PSO 1.05, datë 07.06.2010).

³ Kapitulli C, paragrafi 7.2 i PSO-së ‘Vendosja, trajtimi, ruajtja e sendeve dhe dëshmime të konfiskuara’

⁴ Kapitulli C, paragrafi 7.3 i PSO-së ‘Vendosja, trajtimi, ruajtja e sendeve dhe dëshmime të konfiskuara’

4. PËRSHKRIMI I OBJEKTIVIT DHE TË GJETURAT

4.1 Zbatimi i proceduarave dhe rregullave mbi vendosjen (Pajisjet- inventari në dhomën e dëshmime si dhe vendosja e dëshmime të konfiskuara.

4.1.1 **Kriteri:** Procedurë Standarde e Operimit PK/SH-PSO 1.05 kapitulli V pika B dhe C me pikat si ne vijim;

- 3.3 (b) “Dhoma e sendeve dhe dëshmime duhet të aplikoj dhe të jetë e pajisur me rafte, kuti metalike si dhe mjete të tilla të ngjashme”
- 3.5 (c) “Shfrytëzimi i rafteve lëvizëse është metoda më efikase dhe e rëndësishme për të rritur hapësirën deponuese”⁵.
- 5.7(a) “Kujdes të veçantë duhet ti kushtohet vendosjes së sendeve dhe dëshmime me veti të lartë të ndjeshmërisë siç janë narkotikët, që duhet të deponohen në dhomë të ndarë apo kupolë brenda zonës së deponimit (b) “Armët e zjarrit duhet të deponohen në dhomë të ndarë apo kupolë brenda zonës deponuese, (d) “Bankënotat dhe gjërat e çmuara duhet të deponohen në sef të ndarë apo kupolë brenda zonës së deponimit të sendeve/dëshmime.
- 5.8 (a,b,c,d,e,f)⁶. a. Çantë veglash për sulmin seksual në-frigorifer (b) “Drogat-nëse është e mundshme në qese të vogla ndaras nga sendet personale” (c) “ Gjaku, urina – në frigorifer” (d) “ Paratë/bankënota- në zarfe bankënotash e. Shiringë, brisk rroje – në kontinier të posaçëm” dhe (f) “ Sendet dhe dëshmitë që janë specifike të paketohen varësisht sipas nevojave”.

4.1.2 **Procedura e inspektimit:** Është bërë kontrollimi fizik si dhe fotografimi i secilës dhomë të dëshmime që ka qenë pjesë e inspektimit. Po ashtu nga ana e inspektorëve është bërë kontrollimi i sendeve dhe dëshmime për të vërtetuar se vendosja e tyre është bërë në përputhje me PSO-në që rregullon “Dhomën e Dëshmime”. Gjithashtu gjatë kontrollimit të dhomave prezent kanë qenë dhe zyrtarët e dhomave të dëshmime nga të cilët dhe është nënshkruar pyetëtori për çdo dëshmi të gjetur.

4.1.3 **Të gjeturat:** Nga shtatë⁷ dhoma të dëshmime të kontrolluara vetëm një ka përmbushur standardet e përcaktuara nga objektivi. Ndërsa prej shtatë dhomave të dëshmime, gjashtë nga to nuk kanë përmbushur standardet e përcaktuara nga objektivi. Andaj, detajet e të gjeturave do ti gjeni të potencuara më poshtë:

- Dhoma Qendrore e Dëshmime, Dhoma e Dëshmime në DRP-Prishtinë, Dhoma e Dëshmime në DRP- Pejë, Dhoma e Dëshmime në DRP-Mitrovicë, dhe Dhoma e

⁵ Dhoma e dëshmime “Vendosja, trajtimi, ruajtja,e sendeve dhe dëshmia të konfiskuara PK/SH-PSO 1.05

⁶ Dhoma e dëshmime “Vendosja, trajtimi, ruajtja,e sendeve dhe dëshmia të konfiskuara PK/SH-PSO 1.05

⁷ Inspektimi i Dhomës Qendrore të Dëshmime, si dhe dhomat e dëshmime në gjashtë Drejtori Rajonale Policore.

Dëshmime në DRP-Gjilan nuk posedojnë kontinier të posaçëm për ti vendosur sendet apo dëshmitë që duhet të ndahen nga sendet e tjera e që konkretisht mund të jenë shiringë, brisk rroje etj.

- Dhoma e Dëshmime në DRP-Prishtinë, Dhoma e Dëshmime në DRP-Mitrovicë, dhe Dhoma e Dëshmime në DRP- Gjilan nuk posedojnë rafte montuese (rafte lëvizëse) e cila është metoda më efikase dhe e rëndësishme që në rast nevojë të rritet hapësira deponuese.
- Dhoma e Dëshmime në DRP-Mitrovicë, Dhoma e Dëshmime në DRP-Gjilan, dhe Dhoma e Dëshmime në DRP-Ferizaj nuk kanë dhomë të ndarë apo ndonjë kupolë brenda zonës deponuese për ti vendosur armët e zjarrit. Po ashtu në këto tri dhoma sendet dhe dëshmitë nuk janë të vendosura ndaras nga njëra tjera sipas specifikave të tyre.

4.2 Zbatimi i procedurave dhe rregullave mbi ruajtjen dhe trajtimin e sendeve dhe dëshmime të konfiskuara.

4.2.1 **Kriteri:** Procedurë Standarde e Operimit PK/SH-PSO 1.05 kapitulli V (B) pikat si në vijim;

- 2.8 “Dhoma e sendeve dhe dëshmime duhet të jetë e thatë dhe ku do qoftë që është e mundur kondicionimi i ajrit për të mbajtur temperaturën dhe lagështinë konstante për t’iu shmangur mykut”⁸.
- 5.1 (c) “Zyrtari policor bënë marrjen e vendimeve në lidhje me opsionet e standardeve të sendeve dhe dëshmime për paketim dhe kombinimet e sistemimit në rafte/kontinier. Nëse sistemi i rafteve është pozicionuar, atëherë dizajnon kutitë sipas masës së rafteve. Nëse sistemi i rafteve është i tillë që mund të rregullohet atëherë shfrytëzon kuti të madhësive standarde”.
- 5.1(h) “Për ti siguruar për një ruajtje më të mirë të sendeve dhe dëshmime zyrtari policor bënë përshtatjen kur madhësia pengon paketimin, duhet të shfrytëzohet etiketa ngjitëse apo ndonjë etiketë tjetër ngjitëse apo shfrytëzuese në mënyrë të tillë që nuk dëmton sendin/ dëshminë”.
- 5.8 (c) “Sendet dhe dëshmitë duhet të jetë të ndara nga dëshmitë tjera si p.sh gjaku,urina- në frigorifer”⁹.

4.2.2 **Procedura e inspektimit:** Është bërë kontrollimi fizik si dhe fotografimi i secilës dhomë të dëshmime që ka qenë pjesë e inspektimit. Po ashtu nga ana e inspektorëve është

⁸ Dhoma e dëshmime “Vendosja, trajtimi, ruajtja,e sendeve dhe dëshmia të konfiskuara PK/SH-PSO 1.05

⁹ Dhoma e dëshmime “Vendosja, trajtimi, ruajtja,e sendeve dhe dëshmia të konfiskuara PK/SH-PSO 1.05 kapitulli V (B) pika 5.1(c,h) dhe 5.8(c).

bërë kontrollimi i sendeve dhe dëshmime për të vërtetuar se ruajtja dhe trajtimi i tyre është bërë në përputhje me PSO-në që rregullon “Dhomën e Dëshmime.

4.2.3 Të Gjeturat: Nga shtatë dhoma të dëshmime të kontrolluara tri nga to kanë përmbushur standardet e përcaktuara nga objektivi. Ndërsa nga shtatë dhoma të dëshmime katër nga to nuk kanë përmbushur standardet e përcaktuara nga objektivi. Andaj, detajet e të gjeturave do ti gjeni të potencuara më poshtë:

- Dhomat e Dëshmime në DRP- Prishtinë, DRP-Mitrovicë, nuk kanë ngrohje gjë e cila jep mëdyshje lidhur me tharjen e dhomës, deri sa dhoma e dëshmime në DRP- Gjilan dhe DRP- Ferizaj kanë probleme sa i përket lagështisë.
- Dhomat e Dëshmime në DRP Mitrovicë, DRP- Gjilan dhe DRP- Ferizaj, nuk kanë qenë të pajisura me kuti të standardizuara, gjë e cila nuk ka përmbushur standardin që të paktën dhomat e dëshmime të jenë të pajisura me to, që edhe kur zyrtarët policor do të vinin në rrethanat e dizajnit të kutive sipas masës së rafteve të konsiderohej se është përmbushur kriteri.
- Dhomat e Dëshmime në DRP Mitrovicë dhe DRP- Gjilan, ka qenë e pamundur të përcaktohet se a ju është bërë përshtatja kur madhësia e sendeve apo dëshmime ka penguar paketimin.
- Dhoma e dëshmime në DRP-Prishtinë nuk është e pajisur fare me frigorifer, deri sa dhomat e dëshmime DRP-Gjilan dhe DRP- Ferizaj janë të pajisur me frigorifer por që nuk janë funksionale, andaj, sendet/dëshmitë e konfiskuara i ruajnë në frigoriferët që gjenden në laboratorët e forenzikës.

4.3 Zbatimi i proceduarave dhe rregullave lidhur me sigurinë e dhomave e dëshmime

4.3.1 Kriteri: Procedurë Standarde e Operimit PK/SH-PSO 1.05 kapitulli V(B) me pikat si në vijim;

- 2.5 “Dera e dhomës së dëshmime preferohet të jetë e punuar nga metali, por mund të jetë derë solide e bërthamës së drurit si zgjedhje e dytë. Kapëset nyjore të derës së dhomës së dëshmime /pronës duhet të jenë të montuara nga brendësia e dhomës, kur janë të montuara kah pjesa e jashtme e derës nuk duhet të hiqen por të sigurohen”.
- 2.9 “Të gjitha dhomat e dëshmime duhet të jenë të pajisura me alarm të ndërhyrjes i cili detekton kur hapet dera pa autorizim”
- 2.10 “Formë e plotësimit apo mundësi alternative për një alarm ndërhyrës mund të merret në konsideratë instalimi i video mbikëqyrësit në hyrje kryesore apo në të gjitha pikat hyrëse”,

- 3.1“ Të gjitha dhomat e sendeve dhe dëshmimeve duhet të jenë të pajisura me spërkatës zjarri, detektor tymi, shuarës të zjarrit”¹⁰.

4.3.2 **Procedura e inspektimit:** Pyetëtori ka përcaktuar standardin i cili është dashur të përmbushet. Nga kjo inspektorët kanë vërtetuar ekzistimin e pajisjeve të cilat janë paraparë si çështje që lidhen me sigurinë. Në qoftë se vetëm njëra nga pajisjet për sigurinë ka munguar, atëherë është konsideruar se nuk është përmbushur standardi nga objektivi i caktuar.

4.3.3 **Të gjeturat:** Nga shtatë dhoma të dëshmimeve të kontrolluara dy nga to kanë përmbushur standardet e përcaktuara nga objektivi. Ndërsa nga shtatë dhomat e dëshmimeve pesë nga to nuk kanë përmbushur standardet e përcaktuara nga objektivi. Andaj, detajet e të gjeturave do ti gjeni të potencuara më poshtë:

- Dhoma e Dëshmisë ne DRP- Mitrovicë nuk e ka të instaluar video mbikëqyrësin tek hyrje kryesore në dhomën e dëshmimeve por as në ndonjë nga pikat hyrëse të saj.
- Dhoma Qendrore e Dëshmimeve, Dhomat e dëshmimeve në DRP- Prishtinë, DRP- Mitrovicë, DRP-Ferizaj, DRP- Gjilan nuk janë të pajisura me spërkatës zjarri, shuarës të zjarrit.
- Dhomat e dëshmimeve ne DRP- Mitrovicë dhe DRP-Gjilan, dyert e dhomave edhe pse kapëset nyjore të tyre janë të montuara kah pjesa e jashtme ato nuk janë të siguruar me asgjë.

4.4 Zbatimi i procedurave sa i përket paketimit –shënimeve të dëshmimeve të konfiskuara

4.4.1 **Kriteri:** Procedurë Standarde e Operimit PK/SH-PSO 1.05 kapitulli V (C)

- 3.6 (a) “Kur zyrtari policor i dhomës së sendeve dhe dëshmimeve pranon sendin apo dëshminë menjëherë merr përgjegjësinë dhe ka për detyrë që të kontrolloj çfarë sasive dhe lloje të sendeve janë paraqitur dhe sigurimi se ato dëshmi janë paketuar në mënyrë të duhur”,
- 3.6 (b) “Zyrtari policor duhet të sigurohet se formularët e dëshmimeve (lista e dëshmimeve dhe zinxhiri i ruajtjes) janë të qarta, të sakta dhe të shkruara në mënyrë të duhur, e kompletuar dhe të krahasoj nëse shënimet e renditura në listën e sendeve/ dëshmimeve në zinxhirin e ruajtjes faktikisht janë paraqitur”.
- 6.1 “Çdo send dhe dëshmi e konfiskuar duhet të paktohet sipas kërkesave individuale të saj.

¹⁰ Dhoma e dëshmimeve “Vendosja, trajtimi, ruajtja, e sendeve dhe dëshmia të konfiskuara PK/SH-PSO 1.05 Kapitulli V(B) pika 2.5, 2.9,2.10, 3.1.

- 6.2 (Paketimi i sendeve dhe dëshmime -mënyra dhe llojet e paketimit) “ Gati çdo gjë duhet të paketohet në letër. I vetmi përjashtim mund të jetë droga, mjete të kontaminuara/ndara nga materiale të rrezikshme dhe mjete letre që janë konfiskuara për shkak të gjurmëve të gishtërinjve”.
- 7.2 Zinxhiri i ruajtjes së sendeve dhe dëshmime është një dokument/formular i domosdoshëm që evidenton dhe prezanton konfiskimin, pranimin -dorëzimin, ekzaminimin, lëvizjet, vendosjen dhe ruajtjen e sendeve dhe dëshmime si dhe prezencën dhe qasjen e zyrtarëve policor. Dokumenti-forma fillon nga polici/personi i parë që ka mbledhë apo pranuar dëshminë/pronën dhe e përcjellë dëshminë gjatë gjithë kohës së rrugëtimit (paketim-ruajtje-ekzaminim-gjykatë).

4.4.2 **Procedura e inspektimit:** Është kontrolluar çdo dosje e rastit (secili send/dëshmi) për të përcaktuar se sendet dhe dëshmitë kanë qenë të paketuara dhe shënuara në mënyrën e duhur. Kështu që sendet dhe dëshmitë të cilat kanë qenë të paketuara dhe shënuara në mënyrën e duhur kanë përmbushur standardin për objektivin e caktuar. Ndërsa ato dëshmi të cilat janë dërguar në laborator për ekzaminim apo me urdhëresë të gjykatës janë shkatërruar, është konsideruar se kanë përmbushur standardin e caktuar nga objektivi.

4.4.3 **Të gjetura:** Nga 91 dosje të kontrolluara¹¹ 68 prej tyre kanë përmbushur standardin e objektivit të përcaktuar. Ndërsa nga 91dosje të kontrolluara 23 prej tyre nuk kanë përmbushur standardin nga objektivi i përcaktuar. Andaj, detajet do ti gjeni të shënuara më poshtë:

- Dhoma qendrore e dëshmime rasti me numër (2012-DHTN-031) zinxhiri i ruajtjes nuk është përcjellë në mënyrën e rregullt gjatë rrugëtimit të sendeve/dëshmime të konfiskuara. Për më tutje, zinxhiri i ruajtjes nuk ka filluar me shënime menjëherë prej momentit kur janë mbledhë apo pranuar substancat narkotike gjë e cila ka bërë që përcjellja e rrugëtimit të dëshmisë gjatë gjithë kohës së saj të fillojë në një periudhë të mëvonshme konkretisht ka filluar në fazën e dytë tek ruajtja. Pra kjo çështje ka ndodhur si pasojë e mos njohurisë së procedurës lidhur me kohën se kur fillon të plotësohet zinxhiri i ruajtjes.
- Dhoma e Dëshmime Prishtinë rasti me numër (2012-) dëshmitë nuk janë paketuar veçantë njëra nga tjetra.
- Dhoma e dëshmime Mitrovicë rastet me numër (2012-BI-211, 2012-BI-230, 2012-BG-119, 2012-BI-121, 2012-BI-124, 2012-BI-193, 2012-KE-10, 2012-BI-6, 2012-BI-50) disa nga këto sende/dëshmi nuk kanë qenë të paketuara në qese letre, nuk kanë pasur shiritin ngjitës, sendet/dëshmitë kanë qenë të vendosura të gjitha së bashku në paketim, si dhe disa nga dëshmitë nuk kanë pasur shënime të plota lidhur me sendet/dëshmitë e konfiskuara që ishin aty.

¹¹ Inspektimi fizik i dosjeve të sendeve /dëshmime të konfiksuarara.

- Dhoma e dëshmimeve Pejë rasti me numër (2012- DI-031) sendet/dëshmitë nuk kanë qenë të paketuara në qese letre si dhe nuk kanë pasur listën e bashkangjitur të sendeve/dëshmimeve.
- Dhoma e dëshmimeve Ferizaj rasti me numër (2012-CD-123,2012-CF-0362,2012-CE-300,2012-CF1886,2012-CF-1995) këto sende/dëshmitë po ashtu i ka përcjell një varg i mangësive ku disa nga to edhe pse nuk kanë pasur paketimin e duhur shiriti mbyllës i tyre ka qenë i dëmtuar duke shkaktuar hapjen e paketimit si dhe disa nga dëshmitë nuk kanë qenë të paketuara në qese letre por, janë vendosur ne qese najloni.
- Dhoma e Dëshmimeve Gjilan rastet me numër (17-DOO-12, 22-EOO3-12, 4-AOO4-12, 18-DOO3-12) këto sende/dëshmi në disa raste janë pakeluar të gjitha së bashku nga që ka qenë e pamundur të vërtetohet nëse paketimi ka qenë në mënyrën e duhur. Nga ky proces ka rrjedh rasti kur vetëm një nga dëshmitë është kërkuar nga Gjykata kompetente që të dërgohet në ekzaminim dhe është dashur të hapet paketimi, dhe pas kësaj dëshmitë tjera nuk janë mbyllur me shiritin mbyllës.

4.5 Zbatimi i procedurave sa i përket evidentimit të dëshmimeve të konfiskuara

4.5.1 **Kriteri:** Procedurë Standarde e Operimit PK/SH-PSO 1.05 kapitulli V (C)

- 3.10 “Informata tjera të kërkuara duhet të jenë të dokumentuara në regjistrin e sendit apo dëshmisë dhe të përmbajë të dhënat nga pika(a) Data/koha e pranimit –dorëzimit të dëshmisë,(b) njësiti hetues,(c) numri i rastit,(d) lloji i veprës penale, (e) informata për policin që e dorëzon sendin/dëshminë,(f) informatat për policin që e pranon sendin apo dëshminë,(g) përshkrimi i çdo mjeti duke përfshirë numrin e mjetit numrin e serisë dhe shenjën klasifikuese dhe (h) pronar, viktimi, i dyshimti etj.
- 3.10 (i)“Të gjitha kutitë e metalta, raftet dhe kabinetet duhet të kenë adresë të qartë lexuese, dhe informatat duhet të jenë të dokumentuara në regjistrin e sendit apo dëshmisë ku duhet të përmbajë të dhëna për lokacionin e deponimit(p.sh:kabineti#A,rafti#3,sirtari1)”.
- 3.11“Pas regjistrimit në regjistrin e dëshmimeve, informata në mënyrë ekuivalente duhet të transferohet në data bazën elektronike.”
- 3.15“Çdo lëvizje e sendit apo dëshmisë,qoftë që është dorëzuar në gjykatë apo në ndonjë njësi tjetër kompetent, i është kthyer pronarit apo personit të autorizuar duhet të regjistrohet në regjistër (fletore) të dëshmimeve dhe në data bazë,
- 3.16 “ Në rast se sendi dhe dëshmia janë dorëzuar për ekzaminim/analiza në laboratorin kriminalistik të PK-së, kjo duhet të regjistrohet në regjistër(fletore) të dëshmimeve dhe në data bazë.

4.5.2 **Procedura e inspektimit:** Është bërë kontrollimi i librit të regjistrimit si dhe i data bazës për të vërtetuar se çdo send/dëshmi që ka qenë pjesë e inspektimit a është regjistruar në mënyrë ekuivalente në të dy regjistrat. Po ashtu është bërë kontrollimi i sendeve/dëshmimeve

se a kanë të evidentuar numrin e kabinës, sirtarit apo kutisë në libër të regjistrit në mënyrë që dëshmia të gjendet në kohën më të shkurtë të mundshme. Ato sende/dëshmi që nuk kanë qenë në dhomën e dëshmive por që janë shkatërruar me urdhëresa nga organet kompetente si dhe që kanë qenë në laborator për ekzaminim janë konsideruar se kanë përmbushur standardin e përcaktuar nga objektivi.

4.5.3 **Të gjeturat:** Nga 91 dosje të kontrolluara 66 prej tyre kanë përmbushur standardin e objektivit të caktuar. Ndërsa 91 dosje të kontrolluara 27¹² prej tyre nuk kanë përmbushur standardin nga objektivi i caktuar. Andaj, detajet do ti gjeni të shënuara më poshtë:

- Dhoma Qendrore e dëshmive rastet me numër (2012-DHTN-0200,2008-XPS-30), të dy nga këto raste edhe pse në libër të regjistrit kanë qenë shënime sa i përket shkatërrimit të dëshmisë ato shënime nuk janë shënuar në mënyrë ekuivalente edhe ne data bazë.
- Dhoma e dëshmive Prishtinë rastet me numër (2012-AD-1162, 2012-AD-1249, 2012-AF-0116), edhe pse të mbuluar me shkresa tjera, në këto raste mungojnë shënime ne libër të regjistrimi (fletore) sa i përket hapësirave ku shënohen çështjet e urdhëresës për ekzaminim, si dhe lidhur me transferimin e sendeve/dëshmive sipas PSO-se.
- Dhoma e dëshmive Mitrovicë rastet me numër (2012-BI-211, 2012-BI-230, 2012-BI-119, 2012-BI-110, 2012-BI-121, 2012-BI-124, 2012-BI-193, 2012-KE-10, 2012-BI-06, 2012-BI-50), shënime nuk janë të regjistruara në mënyrë ekuivalente në data bazë për shkak të mungesës së një programi standard për regjistrim në data bazë. Po ashtu nuk ka shënime në libër të regjistrimit(fletore) dhe as në kabina, rafte, kuti metalike për të kuptuar se ku gjinden sendet/dëshmitë
- Dhoma e dëshmive Ferizaj rastet me numër (2012-CD-123, 2012-CF-300,2012-CF-1886, 2012-CF-1995), data baza nuk është plotësuar me shënime ekuivalente sikur në librin e regjistrimit (fletore), si dhe nuk ka shënime lidhur me datën se kur polici i autorizuar e ka marrë sendin/dëshminë për ta dërguar në ekzaminim. Po ashtu nuk ka shënime në libër të regjistrimit(fletore) dhe as në kabina, rafte, kuti metalike për të kuptuar se ku gjinden sendet/dëshmitë brenda dhomës se dëshmive.
- Dhoma e dëshmive Gjilan rastet me numër (17-DOO-12, 22-EOO3-12, 57-KOO1-12, 40-GO12-12, 4-AOO4-12, 18-DOO3-12), shënime në libër regjistrimi (fletore) nuk përputhen me numrat rendor që janë të shënuara në data bazë, ka shënime të cilat fare nuk janë plotësuar në data bazën elektronike. Po ashtu nuk ka shënime në libër të regjistrimit(fletore) dhe as në kabina, rafte, kuti metalike për të kuptuar se ku gjinden sendet/dëshmitë brenda dhomës së dëshmive.

¹² Kontrollimi fizik i dosjeve lidhur me sendet/dëshmitë e konfiskuara në shtatë dhomat e dëshmive.

4.6.1 Gjithë-përfshirja: Ky objektivi përfshinë në vete çështjet të cilat nuk janë paraparë në objektivat e cekur më lartë, por që gjatë inspektimit, inspektorët kanë hasur në disa çështje të cilat do të potencohen në veçanti.

4.6.2 Projekti i ICITAP-it ka bërë të mundur funksionalizimin e Dhomës Qendrore të Dëshmimeve ku e rëndësishme për tu përmendur është të avancuarit në nivel të lartë sa i përket kushteve të sigurisë së dhomës së dëshmimeve dhe të punës së personelit. Sa i përket menaxhimit të informacionit mbi dëshmitë, dhomat e dëshmimeve janë të pajisura me bazën elektronike të të dhënave mbi dëshmitë, e cila së bashku me investimet që janë kryer në dhomat e dëshmimeve është donacioni i ICITAP-it. Kjo bazë përmban informacion shumë të pasuruar në krahasim me bazat elektronike të drejtorive që ende përdoren në shumë dhoma të dëshmimeve (baza e të dhënave përmban edhe informata mbi kodin e dëshmisë). Personeli i angazhuar është i përgatitur në përdorimin e saj, por vlerëson se asaj është e nevojshme t'i shtohen aplikacione shtesë, si: lloji i artikujve në rastin e narkotikëve (aplikacioni i tashëm nuk precizon llojin specifik të narkotikëve), sasia e narkotikëve etj.

4.6.3 Kështu që ky ndryshim i cili ka centralizuar dhomën qendrore të dëshmimeve dhe avancim i çështjeve të potencuar më lartë ka lënë boshllëk tek dokumentet (PSO) që rregullojnë fushën e Dhomave të Dëshmimeve e në veçanti dhomës qendrore të dëshmimeve.

4.6.4 Sa i përket paketimeve të sendeve dhe dëshmimeve në qese letre është vërtetuar se në shumicën e rasteve të kontrolluara nuk ka pasur shënime në pjesën e dytë mbi qesën e letrës sa i përket zinxhirit të ruajtjes. Thënë me fjalë të tjera nuk është shënuar pjesa e zinxhirit të ruajtjes tek forma (from- to- date), si dhe kjo qese letre nuk përmban shënime në gjuhët zyrtare.

4.6.5 Po ashtu lidhur me Mbikëqyrjen/revizionimin, inventarizimin, dhe inspektimin¹³ si mekanizma të kontrollit të brendshëm të instaluar brenda PSO -it, nuk ka pasur lëvizje të kënaqshme, sepse gjatë inspektimit janë siguruar vetëm dy raporte lidhur me inventarizimin¹⁴ dhe inspektimin¹⁵ e dhomave të dëshmimeve të kryer nga Drejtoria e Hetimeve të Krimeve të Rënda, e që tani janë centralizuar në dhomën qendrore të dëshmimeve.

4.6.6. Ndërsa sa i përket dhomave të dëshmimeve në nivele rajonale janë siguruar raporte për inspektim nga DRP-Gjilan.¹⁶ Raporte për Inventarizim kanë prezantuar DRP-Gjilan, DRP-Pejë, DRP-Mitrovicë¹⁷ dhe DRP-Prizren¹⁸, si dhe raporte për revizionim ka prezantuar DRP-DRP-Prizren¹⁹ dhe DRP-Ferizaj²⁰.

¹³ PK/Sh-PSO 1.05 Kapitulli V pika D

¹⁴ Drejtoria e Hetimeve të Krimeve të Rënda. Raport vjetor informues për dhomën e dëshmimeve 17.12.2012

¹⁵ Drejtoria e Hetimeve të Krimeve të Rënda, raport informues 06.07.2012 Prishtinë.

¹⁶ Raport i Inspektimit DRP –Gjilan ref 04/01-06/HR-248/12

¹⁷ Raport Inventarizimit DRP-Gjilan 05.07.2012-14.07.2012, DRP –Pejë nr. referencës 04/1-03HR-824/12, DRP- Mitrovicë nr. referencës 04/1-02-344/2012.

5. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

5.1 PËRFUNDIMET

5.1.1 Mungesa e hapësirës në pjesën ku janë të përqendruara dhomat e dëshmimeve ka bërë që shumica nga to të mos kenë rafte lëvizëse si dhe nuk kanë dhomë të ndarë apo ndonjë kupolë të veçantë brenda zonave deponuese. Gjithashtu si pasojë e mungesës së furnizimit me pajisje (mjete) pune, shumica e dhomave të dëshmimeve është vërtetuar se nuk janë të pajisura me kontinier të posaçëm për të vendosur sendet/dëshmitë e specifikuar.

5.1.2 Disa nga dhomat e dëshmimeve që kanë probleme me lagështinë ka ndodhur si pasojë e përqendrimit të këtyre dhomave të dëshmimeve në bodrumet e objekteve policore. Po ashtu mungesa e frigoriferëve apo mos vurja në funksion e tyre ka bërë që sendet/dëshmitë të ruhen në laboratorët e kriminalistikës, gjë e cila do të duhej të evitohet për shkak se ruajtja – trajtimi i sendeve/dëshmimeve sipas PSO-it është përgjegjësi e dhomës së dëshmimeve. Ndërsa mungesa e pajisjeve (mjeteve) të punës ka shkaktuar që dhomat e dëshmimeve të mos jenë të pajisura me kuti të standardizuara.

5.1.3 Mungesa e shuarësit të zjarrit si dhe vendosje e siguresave të shtesë për raste kur kapëset nyjore të dyerve kanë qenë të montuara nga ana e jashtme ka bërë që objektivi për sigurinë të ketë një nivel më të ultë të saktësisë, por që me një angazhim minimal nga ana e PK-së do të qartësonte apo rregullonte në nivelin e duhur çështjet lidhur me sigurinë.

5.1.4 Sa i përket çështjeve të paketimeve të sendeve/dëshmimeve të cilat nuk kanë qenë të veçuara nga njëra tjetra si dhe kur sendet/dëshmitë janë paketuar në mënyrën jo të rregullt është identifikuar se në disa raste ose ka qenë si mungesë e njohurive ose mungesë e pajisjeve (mjeteve) adekuate.

5.1.5 Shumica e rasteve në dhomën e dëshmimeve nuk kanë të evidentuar në librin e regjistrimit (fletore) dhe në data bazë lokacionin e sakte se në cilën kabinë, raft apo kuti metalike ndodhen sendet/dëshmitë. Disa nga sendet/dëshmitë nuk janë të regjistruara në mënyrë ekuivalente si në libër të regjistrimit (fletore) dhe në data bazën elektronike, dhe kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së hapësirës për një zyrë ku zyrtari i dhomës së dëshmimeve të qëndroj apo edhe si ngarkesa me punë të tjera që angazhohet personi në fjalë.

¹⁸ Raport Inventarizimi DRP-Prizren nr. Reference NDO-04/1-04/38-2012.

¹⁹ Revizion i Brendshëm i Dhomës së Dëshmimeve (3- mujori i pare 2012) nr. Reference NDO-04/1-04HR-167/2012.

²⁰ Revizion i Brendshëm i Dhomës së Dëshmimeve nr. Reference 04/01-05 HR119-2012.

5.1.6 Donacioni i ICITAP-it, lidhur me pajisjet e avancuara sa i përket sigurisë, kushteve të punës dhe data bazës elektronike i ka lënë boshllëk dokumenteve (PSO) që rregullojnë dhomat e dëshmive më konkretisht Dhomës Qendrore të Dëshmive.

5.1.7 Shumica e rasteve të kontrolluara në dhomën e dëshmive në paketimin prej qese letre nuk kanë shënime sa i përket pjesës së dytë të zinxhirit të ruajtjes (from- to-date), dhe kjo për shkak të mos informimit të duhur për plotësimin në mënyrën korrekte apo për shkak se PSO-it, nuk ka paraparë definim të saktë lidhur me këtë çështje.

5.1.8 Në shumicën e drejtorive hetimore të centralizuara në nivel qendror dhe në drejtoritë rajonale policore nuk janë kryer revizionimet, inventarizimet dhe raporte të rregullta për vitin 2012, që në shumicën e rasteve është identifikuar se mos njohuria për ti veçuar këto tri kategoritë ka sjellë deri te një situatë e tillë.

5.2 REKOMANDIMET

Në drejtim të përmirësimit dhe ngritjes së vazhdueshme të performancës së përgjegjësve të Dhomës Qendrore të Dëshmimeve, IPK-ja ka nxjerrë këto rekomandime:

Rekomandimi 1: IPK-ja i rekomandon drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetës që të intensifikojë bashkëpunimin me drejtorin e Departamentit për Hetime si dhe drejtorët rajonalë në mënyrë që Departamenti për Shërbime Mbështetëse të pajisë dhomat e dëshmimeve me raftë lëvizëse, kontenier, kuti standarde, frigorifer, shuarës të zjarrit dhe pajisje tjera adekuate për secilën dëshmi.

Rekomandimi 2: IPK-ja i rekomandon drejtorët rajonal policor (DRP-Ferizaj, DRP-Gjilan) që të ndër marrin masat adekuate për të eliminuar lagështinë në dhomat e dëshmimeve që ky problem është evident.

Rekomandimi 3: IPK-ja rekomandon drejtorëve rajonal policor të DRP-Mitrovicë dhe DRP-Gjilan që në dhomat e dëshmimeve ku dyert kanë kapëset nga ana e jashtme të vendosin mjete shtesë për sigurimin e tyre.

Rekomandimi 4: IPK-ja u rekomandon zyrtarëve të angazhuar në dhomat e dëshmimeve që në Regjistrin e dëshmimeve dhe bazën elektronik të të dhënave, si dhe në kabina, raftë, sirtarë dhe kuti metalike të prezantojnë edhe informacionin mbi vend ndodhjen e dëshmimeve (lokacionin e saktë të deponimit).

Rekomandimi 5: IPK-ja u rekomandon zyrtarëve të dhomës së dëshmimeve që me rastin e pranimit të dëshmimeve nga hetuesit e rastit të sigurohen se dëshmitë janë të paketuara në paketime standarde, të cilat ruajnë dëshmitë nga dëmtimet e mundshme apo humbjet.

Rekomandimi 6: IPK-ja u rekomandon zyrtarëve të dhomës së dëshmimeve që me rastin e regjistrimit të sendeve/dëshmimeve të bëjë plotësimin e të dhënave në mënyrë ekuivalente edhe në data bazën elektronike.

Rekomandimi 7: IPK-ja rekomandon menaxhmentin e lartë që të merr masa për të siguruar qese letre me shënime në gjuhët zyrtare si dhe të obligojë zyrtarët e dhomës së dëshmimeve për të plotësuar me shënime pjesën e dytë të qeses së letrës për tu siguruar se ka shënime sa i përket zinxhirit të ruajtje (from- to- date).

Rekomandimi 8: IPK-ja rekomandon Drejtorinë për Planifikim Strategjike dhe Çështje Ligjore të angazhohet në përpilimin e një dokumenti të ri që do të rregullonte në përpikëri punën në Dhomat e dëshmimeve.

Rekomandimi 9: IPK-ja rekomandon menaxhmentit të lartë policor që të kenë kujdes sa i përket mekanizmit të kontrollit të brendshëm dhe të angazhohet për të mbikëqyrur dhe të

kërkojë llogaridhënie se a i përket raportimeve lidhur me inventarizimin, revizionimin dhe inspektimin e dhomave të dëshmimeve.

Rekomandimi 10: IPK-ja rekomandon menaxhmentit të lartë të angazhoj Divizionin e Trajnimeve që të organizojnë trajnime adekuate për zyrtarët policor të dhomave të dëshmimeve.

Rekomandimi 11: IPK-ja rekomandon menaxhmentin e lartë të angazhohet për të aftësuar edhe disa persona tjerë alternativ për të pasur njohuri sa i përket punëve në dhomën e dëshmimeve.

Rekomandimi 12: IPK-ja rekomandon menaxhmentin e lartë të angazhohet që të gjitha dhomat e dëshmimeve të aplikojnë data bazën elektronike e cila është donacion i ICITAP-it, në mënyrë që të ketë regjistrim unik (standardizuar).